



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

Ministria e VetëQeverisjes Lokale, Shkup, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian, Tiranë, si struktura operuese përgjegjëse për zbatimin e këtij Programi IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar, njofton:

Konkurs për videon e shkurtër më krijuese me temë:

"Pesë arsye përse unë, dua të vizitoj vendin fqinj!"

Konkursi për videon e shkurtër të bërë vetë (kohëzgjatja maksimumi 60 sekonda) nis më 28 Shtator 2017 dhe do të zgjasë deri më 31 Tetor, 2017.

Pjesëmarrësit e interesuar, për një video të shkurtër (selfie) duhet të përcaktojnë në mënyrë krijuese se cilat janë 5 arsyt e preferuara të tyre, (arsye personale) për të cilat duan të vizitojnë vendin fqinj. Shtetasit nga një vend të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në konkurs, duhet që në këtë video të shkurtër, të deklarojnë se cilat janë 5 arsyt përse ata duan të vizitojnë vendin fqinj.

Njoftimi dhe dhënia e çmimit për tre videot e propozuara më krijuese (Çmimi i Parë, i Dytë dhe i Tretë) do të zhvillohet në date 10 Nëntor, 2017 në Strugë si pjesë e eventit të "Panairit të Përbashkët të Punimeve Artizanale".

MË SHUMË RRETH RREGULLAVE PËR PJESËMARRJEN NË KËTË KONKURS GJENI NË FAQEN ZYRTARE FACEBOOK TË KËTIJ PROGRAMI TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR:

<https://www.facebook.com/IPA2CBCMKAL>

(Deri tani, do të shkojë si një lajmërim)

Rregulla dhe udhëzime për pjesëmarrjen në konkursin e videos.

"5 (PESË) arsyt përse Unë dua të vizitoj vendin fqinj "

1. Të gjitha videot e dorëzuara duhet të jenë në formatin e videos dixhitale.
2. Çdo video e dorëzuar nga pjesëmarrësit duhet të fokusohet rreth vendit fqinj.
3. Të gjithë pjesëmarrësit e interesuar mund të punojnë së bashku (në grup) ose të dorëzojnë regjistrimet e tyre individualisht.



THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

THIS PROJECT IS IMPLEMENTED BY:



MINISTRY OF LOCAL SELF-GOVERNMENT



MINISTRY OF EUROPEAN INTEGRATION



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

4. Kohëzgjatja e videos nuk duhet të kalojë 60 sekonda (një minutë).
5. Gjithashtu, të gjitha videot e ngarkuara, duhet të kenë një tekst në formatin e një dokumenti bashkëlidhur i cili të përmbajë të dhënat si më poshtë:
 - Emrin dhe mbiemrin e aplikantit/pjesëmarrësit;
 - Adresën, e-mailin dhe numrin e telefonit.
6. Plagjiatura të çdo lloji do të rezultojnë me skualifikimin e propozimit.
7. Video të grupuara-propozime të gatshme duhet të kenë një prurës të vetëm (Emër, Familje, Kontakt). Nqs propozimi është përzgjedhur për çmimin fitues, do t'i jepet atij që është caktuar si dorëzuesi kryesor i video propozimit.
8. Nuk ka asnjë pagesë për pjesëmarrjen në këtë konkurs.
9. Regjistrimet mund të dorëzohen nëpërmjet adresës së e-mailit zyrtar për pjesëmarrjen në konkurs: **104neighbour@gmail.com**, duke nisur nga 28 Shtator 2017. Afati i fundit për dorëzim është data 31 Tetor, 2017, ora 17:00. Fituesit do të shpallen zyrtarisht në datën 10 Nëntor, 2017, në një aktivitet që do të organizohet, por më parë do të kontaktohen përmes telefonit dhe e-mailit.
10. Materialet si muzika, fotografitë, etj. të autorëve të tjerë, nuk mund të përdoren për këtë konkurs, vetëm nëse pjesëmarrësi/pjesëparrësit zotërojnë të drejtën e autorit ose kanë leje për të përdorur matariale për këtë garë (në formë të shkruar).
11. Të gjithë shtetasit nga të dyja vendet përfituese kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë konkurs.
13. Përmbajtja e videos duhet të përputhet me të gjithë legjislacionin vendor dhe kombëtar të vendit, si dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së.
14. Përmbajtja nuk duhet të: 1) promovojë sjellje të paligjshme; 2) ketë mundësinë të mbështesë osë inspirojë paragjykimet racore, fetare, seksuale ose të tjera; 3) përkrahë dhunën seksuale ose shfrytëzimin; 4) dhunojë të drejtat e njeriut të vendosura me ligj; 5) dhunojë privacinë;
15. Vendimi i jurisë është përfundimtar (final). Të gjitha videot e pranuar sipas afatit të përcaktuar, do të vlerësohen sipas temës dhe zgjidhjes krijuese.
17. Organizatorët e këtij konkursi kanë të drejtën të përdorin videot e dorëzuara për fushata të ardhshme për qëllimet e programit ndërkuftar.



THIS PROJECT IS FUNDED BY THE
EUROPEAN UNION

THIS PROJECT IS IMPLEMENTED BY:



MINISTRY OF LOCAL
SELF-GOVERNMENT



MINISTRY OF EUROPEAN
INTEGRATION



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

18. Pjesëmarrësi është i detyruar dhe duhet të mbajë të paktën një kopje të video propozimit të dorëzuar. Organizatorët e garës nuk janë përgjegjës për videot e sugjeruara të cilat janë humbur, dëmtuar, ose të ngarkuara jo siç duhet.

19. Organizatorët rezervojnë të drejtën për të anuluar, pezulluar dhe / ose ndryshojnë këtë garë, ose çdo pjesë të saj, nëq ndonjë virus, bug, ndërhyrje njerëzore e pa-autorizuar, mashtrim, gabime teknike, gabime njerëzore ose çdo lloj faktori që dhunon integritetin ose funksionimin siç duhet të konkursit, të vendosur nga financieri (EU). Financieri rezervon të drejtën për të skualifikuar çdo individ i cili do të përpiqet të veprojë në kundërshtim me rregullat për pjesëmarrjen në këtë konkurs.



THIS PROJECT IS FUNDED BY THE
EUROPEAN UNION

THIS PROJECT IS IMPLEMENTED BY:



MINISTRY OF LOCAL
SELF-GOVERNMENT



MINISTRY OF EUROPEAN
INTEGRATION